LIGJ
Nr. 44/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 29 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4, 6, 7 dhe 12 ndryshohen si më poshtë:

"3. Pavarësisht nga dënimi kryesor me gjobë, të parashikuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vetë ose me propozimin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës, mund t'i propozojë ministrit pezullimin apo revokimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj, masë e cila është dënim plotësues.

4. Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës shqyrton dhe merr përfundimisht vendimin në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

6. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

7. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike.

12. Çdo masë administrative e marrë në zbatim të këtij ligji ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.".

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 2
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin 8003, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani